

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**SHOQERIA TREGTARE**  
**“MONDJAL” SH.P.K**

**V E N D I M**  
**ASAMBLESE SE ORTAKUT TE VETEM NR 4**  
**DATE 20.10.2005**

Shoqeria “MONDJAL” sh.p.k eshte e regjistruar si person juridik me vendimin Nr 16759 date 23.01.1997 te Gjykates se Rrethit Tirane .

Sot ne mbledhjen e dates 20.10.2005, Asambleja e Oratakeve te shoqerise “MONDJAL” sh.p.k mori ne shqyrtim aktivitetin e shoqerise dhe ecurine e saj ne te ardhmen dhe ne perputhje me statutin dhe ligjin

**V E N D O S I :**

3. Miratimin e Raportit te Ekspertit per vleresimin e kapitalit.
4. Miratimin e shteses se kapitalit ne vleren 53.974.564 leke duke arritur ne kete menyre kapitali i neneshkruar i shoqerise ne shumen 54.074.564 leke.  
Depozitimim e ketyre ndryshimeve ne regjistrin tregtar.

**ASAMBLEJA E ORTAKUT TE VETEM**

**ZAK TOPUZI**



**MONDJAL HOTEL**  
Rr. M. Gjollësia  
Tel 042) 82372  
Tiranë Albania

# **RAPORT**

I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR

**" MONDJAL " SH.P,K**


SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
TIRANE

RAPORT I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR  
I PARASHIKUAR NGA NENET E LIGJIT 7638 DT.19.11.1992  
" PER SHOQERITE TREGETARE " .

TIRANE , ME                      2005

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR

THOMA JANKO

  
Eksperit K. A.  
THOMA JANKO  
Lifensa Nr 118

## **Asamblese se Ortakut te vetem te shoqerise " MONDJAL "Sh.P.K.**

### **I nderuar Zoteri !**

Me vendim te Asamblese se Ortakut te Vetem nr 3 date 05.10.2005 ne kuadrin e projektit per zmadhimin e kapitalit themeltar nepermjet fitimit vjetor neto, fitimit te trashesguar dhe financimit nga ortakut te shoqerise tuaj , jam caktuar si ekspert ne kete mision sipas ligjit " Per shoqerite tregetare " , 7638 dt. 19.11.1992 .

Une kam nderin tu raportoj juve per ekzekutimin e ketij misioni , i cili konsiston ne vleresimin e vlerave te pasurise qe perbejne aktivin e shoqerise , dhe verifikimin qe shuma e kapitaleve te veta eshte te pakten me ate te kapitalit themeltar .

Per kryerjen e ketyre misioneve ne kemi disponuar bilancin e shoqerise te hartuar per dt.31.12.2004 ,date e mbylljes se ushtrimit te fundit dhe te ekspertuara nga ana e jone , si dhe dokumente te tjera te nevojshme per kontrollin e elementeve te ketyre bilanceve .

Kontrollet tona u kryene ne seline e shoqerise ku hartohen bilancet dhe dokumntat kontabel dhe na u dhane spjegime dhe justifikime plotesuese per elementete e bilanceve te shqyrtuara si dhe per evoluimin e situates se shoqerise qysh nga data e mbylljes se ushtrimit financiar te fundit .

Ne baze te hapave te ndermara e te punes se kryer , ne jemi ne gjendje tu bejme te njohur perfundimet qe vijojne ne kuadrin e raportit te parashikuar nga ligji .

### **A-VLERA E PASURIVE QE PERBEJNE AKTIVIN E SHOQERISE**

Per shkak te natyres se operacionit te projektuar misioni yne i verifikimit konsistonte nevojshmerisht per te vleresuar jo aq peshen ( rendesine , materialitetin ) e plus vlerave eventuale te fshehta ( latente ) se sa per tu siguruar qe vlerat kontabile per te cilat anetaret jane thirrur te marrin nje vendim nuk cojne , ne fakt , ne nje mbivleresim te pasurise se shoqerise .

Aktivi i shoqerise i pasqyruar ne bilanc perbehej nga elemente qe vijojne :

Aktive te Qendrueshme	111.898.671 Leke
Aktive Qarkulluese	12.893.048 Leke
<b>Shuma</b>	<b>124.791.719 Leke</b>

Ne kunderparti :

- Detyrime te kerkueshme deri ne nje vit	288.133 Leke
<b>Shuma</b>	<b>288.133 Leke</b>

Aktivi neto kontabel rezulton keshtu :

**124.791.719 – 288.133 = 124.503.586 Leke**

Kapitalet e veta jane **124.503.586 Leke**  
Sa me siper kapitali e veta perbehen si me poshte :

Kapitali i neneshkuar	100 000	Leke
Lehtesi tatimore	1.240.022	Leke
Fitime te mbartura	1.439.570	Leke
Fitimet e vitit 2004	2.214.994	Leke
Llogaria e ortakut	119.509.000	Leke
<b>Shuma</b>	<b>124.503.586</b>	<b>Leke</b>

Vleresimi i cdo posti te aktivitet dhe pasivitet ka qene objekt i nje shqyrtimi te vemendshem ne kushtet e paraqitura me poshte :

#### AKTIVET E QENDRUESHME

a)Aktivet e qendrueshme te patrupezuara shoqeria nuk disponon.

b)Aktivet e qendrueshme te trupezuara.

Elementet e trupezuar , Keta elemente jane detajuar ne anekset e bilancit te 31 dhjetorit 2004 qe ne i kemi lidhur raportit tone . Shqyrtimi ( verifikimi ) ne te cilen kemi proceduar ka te beje me justifikimin e blerjeve te kryera dhe ekzistencen e pasurive te Aktiveve te Qendrueshme te Trupezuara .

Aktivet e Qendrueshme te Trupezuara jane pasqyruar ne bilanc me koston historike , korrigjuar me amortizimin dhe me vleren e tyre neto . Vlera neto e tyre ne bilancin date 31.12.2004 eshte 111.898.671 leke. Ne totalin e aktiveve te qendrueshme peshen kryesore e ze vlera bruto e hotelit per 95.756.000 leke sume e cila eshte e situacionuar dhe sipas kryqezimit te financimeve qe ne beme rezultoj se nga llogaria rrjedhese e pronarit jane likujduar vetem 50.320.000 leke dhe vlera tjeter pretendohet se eshte bere me para ne dore. Ne keto kushte une vertetoj si llogari te pronarit vetem shumen e me siperme qe te kaloj dhe si shtese kapitali.

Per sa i perket AQT-ve dhe permirsimeve ( rregullimeve ) te kryera , si dhe makinerive dhe elemente te tjere te trupezuar te shfrytezimit , ne u siguroam qe amortizimet jane llogaritur e rregjistruar rregullisht . Vlera neto kontable gjenden ne menyre te pergjithshme ne nivelin ose poshte nivelit te vlerave te dobishmerise ose te vijimesise se shfrytezimit .

#### AKTIVET QARKULLUESE

Aktivet qarkulluese perbehen :

- gjendje inventari	6.383.457	Leke
- Kerkesa per arketim mbi debitoret	662.860	Leke
- likuiditete dhe vlera arke	5.846.731	Leke
<b>Shuma</b>	<b>12.893.048</b>	<b>Leke</b>

Gjendjet e inventarit egzistojne dhe vleresimi i tyre eshte bere i sakte.

Kerkesa per arketim mbi debitoret per Leke 662.860 , ekzistojne dhe jane te arketueshem duke qene nje vlere pasurore aktuale per shoqerine tregtare .

Likuiditetet per 5.846.731 Leke te pasqyruar ne bilancin perkates , rezultojne se perputhen me inventarin fizik te monedhes ne arke, dhe stricon e fundit te bankes me 31.12.2004 .

## DETYRIMET

Ne verifikimin e kryer ne rubrikat e bilancit detyrime per vleren 288.133 Leke , rezulton se ato perbehet nga :

- Detyrime te kerkueshme deri ne nje vit	288.133 Leke
Shuma	288.133 Leke

Shqyrtimi ( verifikimi ) i posteve te pasiveve te kerkueshme ( detyrime ) nuk ka nxjerre asgje jonormale , duke patur parasysh qe deri ne daten e nderhyrjes tone , nuk morem dijeni per ndonje konflikt ose rrezik te mundshem per te ndryshuar situaten e shoqerise .

## PERFUNDIMI

Ne perfundim te verifikimeve te bera dhe duke patur parasysh hollesite e dhena me siper ne cmojme qe vlera neto kontabile e elementeve qe perbejne aktivin e shoqerise , ashtu sic dalin keto vlera nga pasqyrat financiare qe i jane aneksuar ketij raporti , jane ne pajtueshmeri me rregullat dhe parimet kontabel ne fuqi dhe perbejne nje vleresim normal dhe te arsyeshem .

## B-KAPITALET E VETA DHE KAPITALI THEMELTAR

Per percaktimin e vleres per zmadhimin e kapitalit themeltar eshte ndjekur metoda e vleres neto kontabel , qe llogaritet nga aktivi real duke zbritur detyrimet aktuale te saj te cilat jane reale .

- Aktivet kontabile	124791.719 Leke
- <u>Detyrimet aktuale</u>	<u>288.133 Leke</u>
- Kapitalet e veta	124.503.586 Leke

## KONKLUZION

**Kapitali i neneshkruar i shoqerise me vendim gjykate nr. 16759 dt. 23.01.1997 ishte 100 000 Leke dhe me vleresimet tona bazuar ne kerkesen e shoqerise dhe vendimin e asamblese se Ortakut te vetem behet 54.074.564 leke. (100 000 leke +3654564 + 50.320.000 leke qe perfaqeson fitimin e akumuluar dhe pjeserisht llogarin e ortakut).**

Si rezultat i ketyre veprimeve ne ngjerjet ekonomike te shoqerise do te kryhet ky veprim kontabel:

Debi llogaria "fitime te mbartura"	1.439.570 leke
Debi llogaria "fitime te ushtrimit"	2.214.994 leke.
Debi llogaria " ortakut"	50.320.000 leke.
<b>Kredi "kapitali i neneshkruar "</b>	<b>53.974.564 leke.</b>

Sa me siper kapitali themeltar rezulton si me poshte :

Kapitali i neneshkruar	54.074.564 leke.
Lehtesia tatimore	1.240.022 leke.
Llogaria e ortakut	69.189.000 leke

Per te qene ne pajtim me ligjin , **ne vertetojme** se shuma e kapitaleve te veta te shoqerise , e cmuar ne baze te dokumentave per gjendjen me 31.12.2004 te cilat na u komunikuan dhe ne i verifikuam jane te sakta dhe vendimi i Asamblese se Ortakut te vetem per kapitalizimin e fitimit te pashpermdare eshte i drejte ndersa per llogarin e ortakut te mbetet si shtese kapitali vlersimi jone pere 50.320.000 leke dhe jo 119.509.000 leke sikurse pretendohet.

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR

ERHOMË JANKO  
Ekspert Kontabel  
THOMA JANKO  
Licensa Nr. 118